

## KAPITULLI NJEMBEDHJETE

### PLANI RAJONAL DHE IMPLEMENTIMI I TIJ

#### 11.1 HYRJE: DUKE SINTETIZUAR STRATEGJINE DHE TAKTIKAT

Ky dokument ka shpallur Qellimet dhe Objektivat (Kapitulli 2) dhe ka permbledhur konceptin e planit, (Kapitulli 3). Me pas perpunoj detajet çeshtje pas çeshtjeje, duke mbuluar Dhenien e Tokes me Sherbime te Kryera (Kapitulli 6); Infrastruktura Strategjike (domethene Uji, Kanalizimet, Energjetika, Rrugjet Kryesore dhe Transporti Publik) (Kapitulli 7); Zhvillimin Ekonomik (Kapitulli 8); Ambjentin (Kapitulli 9); dhe Zhvillimin e Zonave te Thella (Kapitulli 10). Secili prej ketyre kapitujve identifikonte projekte te veçanta, me kostot e buxhet-fazave, dhe paraqiste nje pikturë te propozimeve ne secilin kapitull te veçante.

Qellimi i ketij kapitulli eshte sintetizimi i planit te pergjithshem nga pjeset e tij perberese, dhe te paraqesim sebashku mjetet dhe synimet: me fjale te tjera te diskutojme institucionet, financimin dhe menaxhimin e planit. Hartat perberese te planit nga Kapitujt 6 deri 10 jane te sintetizuara ne Figuren 11.1

#### 11.2 ZHMLIMI I INSTITUCIONEVE

##### 11.2.1 Nje Autoritet i Vetem i Planifikimit Rajonal per Shqiperine e Veriut

Rajonet e Shkodres dhe Lezhes padyshim qe ndodhen ne strukturen e punes se qeverise shqiptare, por ato nuk jane rajone ne formen me te pergjithshme te Evropes, dhe as nuk koordinohen mire me sistemin NUTS<sup>1</sup>. Plani rajonal i tanishem duhet rrjedhimisht te zgjerohet per t'u bere nje 'Plan Rajonal i Shqiperise se Veriut', ne brendesi te strukture se punes se nje 'Plani Kombetar Hapesiror'. Duket se nga kendveshtrimi i Planifikimit Rajonal, si Shkodra edhe Lezha jane shume te vogla qe te funksionojne optimalisht. Ndoshta gjenden kater rajone te verteta ne Shqiperi, nder te cilat Shqiperia e Veriut eshte njera prej tyre. Kjo duhet te perfshije jo vetem Shkodren dhe Lezhen, por edhe rajonin e Kukesit, se paku. Duhet te udhehiqet si nje rajon i vetem, dhe padyshim qe kjo lloj reforme do te ndodhe ne menyren e duhur. Deri ne ate kohe, ne rekomandojme qe te autoritetet te perbejne perkohesisht nje autoritet te

vetem planifikimi qe te menaxhoje dhe te implementoje nje plan rajonal, duke perdorur ligjin mbi Qeverine Vendore te vitit 2000 dhe sigurimin per delegimin ndaj entiteteve te perbashketa.

##### 11.2.2 Komiteti i Pertej-Kufirit per Zhvillimin e Shqiperise se Veriut, Kosoves dhe Malit te Zi

Ky plan kap edhe nje perspektive pertej-kufitare, qe mbulon Kosoven dhe Malin e Zi, (duke perfshire edhe konceptin 'PodShkod' per nje rajon urban policentrik). Ne kete faze, sugjerohet qe te vendoset nje komitet i perbashket nga tre qeverite, duke u takuar çdo tre muaj, ndoshta.

##### 11.2.3 Autoritetet e Planifikimit Rajonal ose Agjensite e Zhvillimit

Autoritetet e Planifikimit Rajonal do te pergatisin me detaje shtate planet lokale (shih Kapitullin 6) dhe gjithashtu do te perforcjone ligjin. Argumentohet qe kufinjte e bashkive dhe komunave jane shume te vogla per (a) te mbuluar territorin e planeve lokale urbane dhe rurale te propozuara ketu dhe (b) te mbeshtesin mjaftueshem entitete te medha per sa u perket buxheteve operuese dhe per stafet. Ne gjithashtu sugjerojme ketu qe komunat dhe bashkite te bashkepunojne per te krijuar autoritete planifikuese me te medha dhe me te pakta ne numer: shih Figuren 11.2. Ne Tabelen 11.1 kemi skicuar vete planet, (te cilat jane pershkruar ne kapitujt e meparshem) dhe kemi treguar emrat e bashkive dhe komunave qe do te bashkepunonin ne menyre qe te pergatiten dhe menaxhohen planet.

Ne kemi parashikuar qe planet e qytetit Shkoder, Velipojes dhe Bushatit te mbulohen nga nje autoritet; qyteti Lezhe, Shengjini dhe Vau i Dejes te mbulohen nga nje tjeter; dhe qe Korridori Koplik-Shkoder te mburohet nga nje i trete. 'Grupet' rurale te thella, (te permendura ne Tabelen 11.2) do te jene nen pergjegjesine e tre autoriteteve te tjera, duke u bere gjashte ne total. Shih paragrafin 11.2.6 me poshte.

<sup>1</sup> D.m.th., Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat

Agjensia Zhvillimit L.P.A	Planet Lokale	Bashkite Komunat e
Shkoder	Qyteti Shkoder (Fig 6.1) Bushat (Fig 6.6) Velipoje (Fig 6.5)	Shkoder, Vau i Dejes, Bushat, Barbullush, Velipoje, Ana e Malit, Berdice, Dajç, Guri i Zi, Hajmel, Rrethinat.
Lezhe	Qyteti Lezhe (Fig 6.3) Vau i Dejes (Fig 6.7) Shengjin (Fig 6.4)	Lezhe, Shengjin, Balldren, Zejmen, Shenkoll, Kallmet, Blinisht, Dajç
Malesi e Madhe	Korridor i Koplik-Shkoder (shih Fig 6.2)	Koplik, Bajze, Qender, Gruemire, Kastrat

**Tabela 11.1 Agjensite e Zhvillimit ne Zonat Urbane**

#### 11.24 Konsorciumet e Pronesise se Tokes dhe Trustet e Zhvillimit

Pronaret e tokave brenda kufirit te secilit plan lokal do te perbejne nje konsorcium, me perqindjet e aksioneve te siperfaqes se tokave te tyre, (jo vleren e tokes ne fillim apo ne fund).

Nje 'Trust' do te bente dy gjera kryesore. Do te (a) vinte ne perdorim truallat per zhvillim, por jo me shume se nje truall per familje (megjithese familjet do te mund te 'tregtojne' duke blere nje truall te ri dhe shitur te parin); (b) lejonte tenderimet e kontratave per ndertimin e infrastruktures fizike lokale (dhe ndoshta infrastrukturen sociale gjithashtu). Te ardhurat do te perdoren per te financuar investimin, dhe te ardhurat neto te harxhimeve do t'i ktheheshin pronareve te tokave sipas perqindjeve te aksioneve te tyre. *Nese pronesia e ndonje toke do te ishte e diskutueshme, atehere trusti do te mbante te ardhurat nga shitjet si nje tutor i besueshem derisa gjykatat te kene zgjidhur çështjen perfundimisht, dhe pastaj do te paguanin parate.*

Trusti duhet te jete ne gjendje te veproje edhe si nje pronar social, duke ndertuar banesa per t'ua dhene familjeve te varfra apo jo te afta, duke perdorur (le te themi) deri 20% te vleres se asetit per te realizuar kete gje.

#### 11.25 Struktura Institucionale e Sektorit te Infrastruktures se Ujesjellesve dhe Kanalizimeve te Ujerave te Zeza

Sipas vendeve te nenzhvilluara dhe ne zhvillim e siper, sistemet e ujesjellesve dhe kanalizimeve te ujerave te zeza jane entitete vepruese te lokalizuara nen kontrollin e drejteperdrejte te pushtetit vendor.

Ne nje aspekt, zakonisht kjo eshte nje cilesi pozitive, pasi krijon pergjegjshmeri institucionale "afere klientit" ose perdoruesit perfundimtar. Megjithate, meqe sistemet e ujesjellesve dhe kanalizimeve jane kapitalisht intensive, dhe kerkojne nje nivel mjaft te larte burimesh njerezore te kualifikuara, me aftesi te ndryshme per menaxhimin, perdorimin dhe mirembajtjen e tyre, ka nje ndikim te qarte te kostos kur konsiderohen ekonomite e niveleve.

Te gjitha sistemet qe jane aset te Shtetit tani per tani, jane skicuar qe t'i transferohen pushtetit vendor, ose permes transferimit te aksioneve te kompanive, ose permes transferimit te aseteteve te vecanta. Periudha e transferimit eshte nje kohe optimale per pushtetet vendore ne korridorin e zhvillimit te siperfaqes se planifikuar qe te konsiderojne forma me te rajonalizuara per shperndarjen e ujesjellesve dhe kanalizimeve te ujerave te zeza.

Formimi i tre institucioneve rajonale per shperndarjen e sherbimeve te ujesjellesve dhe kanalizimeve brenda korridorit te zhvillimit te siperfaqes se planifikuar do te ishte afer realitetit nese merret ne konsiderate. Jane sugjeruar tre kompani: Shkoder, Lezhe dhe Malesi e Madhe. Komunat perberese do te jene po ato te agjensive te zhvillimit: shih Tabelen 11.1.

Keshilli Mbikqyres i ketyre rajoneve do te konsistonte ne perfaqesimin e çdo njesie te pushtetit vendor qe do te njihet si pjese perberese e zones se caktuar te sherbimit.

#### 11.26 Agjensite e Zhvillimit per Zonat e Thella

Ne parashikojme qe komunat rurale do te grupohen bashke ne menyre qe te implementojne strategjine per zonat e thella (shih Kapitullin 10) sic tregohet ne Tabelen 11.2.

#### 11.27 Perforcimi dhe Planifikimi

Me shume mundesi, çështja e vetme me e madhe (dhe me problematike) eshte perforcimi i planeve ne Shqiperi. Kjo eshte nje çështje per politikat kombetare, dhe ndodhet jashte qellimit te planit rajonal. Ne e kufizojme veten vetem ne komentimin mbi çështjen e

'diskrecionit administrativ', sepse kjo ndikon stilin dhe permbajtjen e planit te tanishem.

Sistemi i implementimit per planifikimin duhet te zvogeloje qellimin e ushtrimit te opinionit apo gjykimit nga administratoret dhe politikanet, sepse kjo krijon mundesi per korrupsion. Nje plan apo nje dokument 'zyrtar' i ngjashem duhet te thote (sa te jete e mundur) se çfare eshte ose

Agjensite	Grupet e Planeve	Bashkite dhe Komunat
Agjensia e Zhv. Zones Rurale Veriore	Hot-Vermosh Shale-Theth (Shih Fig 10.1)	Kelmend, Shkrel, Shale, Pult, Shosh, Postribe.
Agjensia e Zhv. Zones Rurale Qendrore	Koman-Ungrej Fierze-Qafe Mali (Shih Fig 10.2)	Temal, Shllak, Fierze, Iballe, Qelez, Qerrat, Blerim, Fushe-Arrez, Qafe Mali, Rrape, Puke, Vig-Mnele, Ungrej.
Agjensia e Zhv. Zones Rurale Lindore	Fan Mirdita (Shih Fig 10.3)	Rubik, Rreshen, Kthjelle, Sellite, Orosh, Fan, Gjeggjan,.

**Tabela 11.2 Agjensite e Zhvillimit per Zonat e Thella**

- **automatikisht e lejuar**, (keshtu qe nuk nevojitet asnje leje apo autoritet nga qeveria ne rast se ndiqen rregulla te qarta); ose
- **universalisht te ndaluara**, (keshtu qe nuk do te ishte e vlefshme ligjerisht asnje leje, edhe sikur te 'merrej vendim').

Me shume mundesi kjo nuk eshte 100% e mundshme, por sasia e lejeve te tilla te nevojshme duhet te minimizohet. Te gjitha rastet e tilla te diskrecionit administrativ duhet te menaxhohen nga gjyqe zyrtare dhe publike dhe jo nga individet apo grupet e vogla. Si aplikimet ashtu dhe vendimet duhen publikuar ne gazeta dhe te njoftohen tek vete institucionet. Dokumentat e politikave (duke perfshire te gjitha planet), duhen publikuar ne nje menyre te hapur dhe te arritshme.

Konkretisht, nje plan lokal duhet pra te perfshije harta qe percaktojne pa dyshime apo pasaktesia

- Zona Ndertimi, duke perfshire truallte ndertimi dhe rruge publike dhe te drejtat e rruges, dhe
- Zona 'Mos Ndertimi', (edhe ngaqë toka ne te cilen ndertimi automatikisht nuk u lejua do te ishte automatikisht ilegale).

Kushtet e vena ne plane duhet te jene te thjeshta dhe te qarta, keshtu qe nuk do te ngrihesh asnje debat. Per shembull, toka e perdorur per nje truall te vecante mund te perkufizohet si krejt rezidenciale apo nje qe perjashton cdo tip rezidencial. Lartesia mund te perkufizohet si numri maksimal i kateve, dhe distanca minimale nga kufiri i truallit mund te vihet ne metra, (si pjese e planit lokal).

Ky kendveshtrim shpesh quhet themeli i 'fuqise policore', (qe lidhet me politikaten e Sh.B.A-se) dhe mund te krahasohet me themelin e 'drejtimit administrativ', (qe lidhet me traditen planifikuese te Mbreterise se Bashkuar). Ne Shqiperi, eshte e qarte qe kjo nuk do te funksiononte per shkak te korrupsionit.

Ne cilat zona do te jete i pashmangshem diskrecioni administrativ? Mund te jene dy zona te tilla.

- Zonat Rurale: ketu do te jete e nevojshme te lejohen shtepite e fermerëve, hambaret, gropat e silazhit dhe stallat. Kjo nuk duhet te perdoret si nje justifikim per ndertimin e shtepive per ata qe jetojne ne ekonomine urbane. Nese lejohet me shume se nje shtepi per cdo 10 hektare, atehere dicka ka shkuar gabim.
- Zonat Urbane Ekzistuese: ketu nuk duhet te ndalohet rigjenerimi urban. Per shembull, vendet dhe ndertesat e shkaterruara duhen te zevendesohen. Ne Evropën Perendimore, do te pergatiten plane rinovuese per te kontrolluar kete, por do te jete e veshtire qe kjo te behet ketu, dhe ne te vertete do te jete e pashmangshme zgjidhja deshtuese.

Kodi	Projekti	Prioriteti	Faze/ Buxhet €milion			
			I.	II.	III.	Totali
H-1	Toka e Qytetit Shkoder	A	1.20	1.20	1.20	3.60
H-2	Toka e Korridorit Koplík -Shkoder	A	1.24	1.24	1.24	3.72
H-3	Toka e Qytetit Lezhe	A	2.12	2.12	2.12	6.36
H-4	Toka e Shengjinit	A	0.66	0.66	0.66	1.98
H-5	Toka e Velipojes	A	0.68	0.68	0.68	2.04
H-6	Toka e Bushatit	A	0.64	0.64	0.64	1.92
H-7	Toka e Vaut te Dejes	A	0.18	0.18	0.18	0.54
H-8	Toka Fshattrash (te ndryshme)	A	0.54	0.54	0.54	1.62
	<b>Nentotali</b>		<b>7.24</b>	<b>7.24</b>	<b>7.24</b>	<b>21.72</b>
I-1	Ujesjellesi Shkoder	A	7.1	7.1	7.1	21.3
I-2	Ujesjellesi Lezhe dhe Shengjin	A	2.4	2.4	2.4	7.2
I-3	Ujesjellesi Vau i Dejes	B	0.7	0.7	0.7	2.1
I-4	Ujesjellesi Malesi e Madhe	B	0.6	0.6	0.6	1.8
I-5	Ujesjellesi Bushat	B	0.6	0.6	0.6	1.8
I-6	Ujesjellesi Velipoje	A	0.8	0.8	0.8	2.4
	<b>Nentotali</b>		<b>12.2</b>	<b>12.2</b>	<b>12.2</b>	<b>36.6</b>
I-7	Kanalizimet Shkoder	A	3.7	3.7	3.7	11.1
I-8	Kanalizimet Lezhe dhe Shengjin	A	1.4	1.4	1.4	4.2
I-9	Kanalizimet Vau i Dejes	B	0.7	0.7	0.7	2.1
I-10	Kanalizimet Malesi e Madhe	B	1.4	1.4	1.4	4.2
I-11	Kanalizimet Velipoje	A	1.3	1.3	1.3	3.9
	<b>Nentotali</b>		<b>8.5</b>	<b>8.5</b>	<b>8.5</b>	<b>25.5</b>
R-1	Tangenciale ne Perendim Shkoder	A	3.7	-	-	3.7
R-2	Shkoder-Hani i Hotit (Podgorice)	A	8.0	-	-	8.0
R-3	Lidhja Veriore Shkoder	B	0.7	-	-	0.7
R-4	Tangenciale ne Perendim Lezhe	B	-	-	3.1	3.1
R-5	Tuneli Lezhe	B	-	-	5.0	5.0
R-6	Tangenciale Vau i Dejes	B	-	3.6	-	3.6
R-7	Vau i Dejes-Bushat	A	-	1.1	-	1.1
R-8	Tangenciale Bushat	A	2.9	-	-	2.9
R-9	Bushat-Velipoje (Ulqin)	A	3.3	-	-	3.3
R-10	Ura e Bunes (Ulqin)	A	4.0	7.2	-	4.0
R-11	Vau i Dejes-Qafe Mali-Kufi	B	-	5.7	-	7.2
R-12	Qafe Mali-Fierze (Tropoje Gjakove)	C	-	6.7	-	5.7
R-13	Milot-Qafe Mali	B	-	-	-	6.7
R-14	Unaza Shengjin	A	1.3	-	-	1.3
R-15	Shkoder-Vau i Dejes	C	1.4	-	-	1.4
R-16	Lezhe-Vau i Dejes	C	2.0	-	-	2.0
R-17	Lezhe-Velipoje	C	1.3	-	-	1.3
R-18	Shkoder-Velipoje	C	1.2	-	-	1.2
R-19	Shkoder-Lagjja Iliria	C	2.0	-	-	2.0
R-20	Shiroke-Zogaj	B	0.8	-	-	0.8
R-21	Tangencialja ne Veri te Lezhes	A	2.8	-	-	2.8
R-22	Tangencialja ne Jug te Lezhes	A	2.7	-	-	2.7
	<b>Nentotali</b>		<b>38.1</b>	<b>24.3</b>	<b>8.1</b>	<b>70.5</b>
PT-1	Shenja, sinjalistike dhe sigurim Trena (tre cope)	A	-	-	0.8	0.8
PT-2	Stacione (gjashtembedhjet)	A	-	-	1.2	1.2
PT-3	Mjete te Shpejta Transporti	A	-	-	1.6	1.6
PT-4	Stacione Transporti	A	-	-	0.4	0.4
PT-5	Studime	A	-	-	0.2	0.2
PT-6		A	-	0.4	-	0.4
	<b>Nentotali</b>		<b>-</b>	<b>0.4</b>	<b>4.2</b>	<b>4.6</b>

Econ-1	Programi i Perforcimit te Tokes ne Agrikulture/Pylltari	A	0.5	0.25	-	0.75
Econ-2	Institucionet per Zhvillimin	A	0.5	0.25	0.10	0.85
Econ-3	Fondi i Rrezikut Kapital/Grant	A	0.75	1.50	0.75	3.0
Econ-4	Permiresime te Ambjentit, Qendrave Turistike dhe Rrugeve	B	0.5	0.75	0.5	1.75
Econ-5	Projekte mbi Peshkimin	B	-	0.5	0.5	1.0
Econ-6	Dhenia e Tokes se Biznesit	A	2.1	2.1	-	4.20
<b>Nentotali</b>			<b>4.35</b>	<b>5.35</b>	<b>1.85</b>	<b>11.55</b>
E-1	Ridrejtimi i Lumit Drin dhe Gjader	A	-	7.00	6.00	13.00
E-2	Thellimi i Lumenjve, Pengimi i tyre	A	10.0	5.00	5.00	20.00
E-3	Mbushja Higjienike e Tokes (Faza e Pare) etj	A	4.00	2.00	-	6.00
E-4	Rehabilitimi i Kanaleve dhe Hidrovoreve	A	3.00	0.50	-	3.50
E-5	Menaxhimi dhe Investimi i Zonave te Mbrojtura	B	3.0	1.50	-	4.50
E-6	Pylltaria Ambientaliste	B	1.0	0.5	-	1.5
E-7	Programi i Reklamimit te Tokes se Demshme/Ndotur	B	2.0	3.0	0.5	5.5
E-8	Studime te Ndryshme te Projektimit Teknik	A	2.0	-	-	2.00
<b>Nentotali</b>			<b>25.0</b>	<b>19.5</b>	<b>11.5</b>	<b>56.5</b>
RD-1	Grupi Vermosh-Hot-Dedaj	A	0.28	0.49	0.37	1.14
RD-2	Grupi Shosh-Shale-Theth	A	0.31	0.48	0.15	0.94
RD-3	Grupi Ungrej-Koman	A	0.21	0.31	0.22	0.75
RD-4	Grupi Qafe Mali-Fierze	A	0.19	0.6	0.37	1.17
RD-5	Grupi Fan	A	0.06	0.48	0.22	0.76
RD-6	Grupi Mirdite	A	0.3	0.39	0.9	1.59
<b>Nentotali</b>			<b>1.36</b>	<b>2.76</b>	<b>1.44</b>	<b>5.56</b>

**Tabela 11.3 Skice e Konsoliduar e Projekteve**

#### 11.28 Organizata te Tjera te Propozuara

Ne menyre qe ky plan te realizohet, mund te kete nevoje per forma te tjera organizimi, si me poshte:

- Ekzekutivi Publik i Transportit te 'PodShkod'
- Agjensia e Zhvillimit Ekonomik per Shqiperine e Veriut
- Banka e Zhvillimit Ekonomik (d.m.th. Fondi i Grantit)
- Bordi Turistik i Shqiperise se Veriut
- Dega e Zhvillimit te Agrikultures dhe Pylltarise
- Sherbimi i Keshillimit Teknik dhe Biznesit
- Agjensia e Marketingut te Produktit

#### 11.3 PLANI I FINANCIMIT TE FAZES SE PARE

##### 11.3.1 Lista e Konsoliduar e Buxheteve te Projekteve

Kapitujt e meparshem permbanin skica te projekteve me buxhete te ndara ne faza. Fillojme duke paraqitur nje liste te konsoliduar: shih Tabelen 11.3.

#### 11.4 Financimi i Procesit te Implementimit

Kostot e buxhetit te dhena ne kete raportim jane perlllogaritje te investimit te kapitalit. Por nuk duhet te harrojme qe implementimi i planit ka gjithashtu nje kosto ne tre menyra.

- *Pune teknike* per pergatitjen e planeve, skicave dhe dokumentacionit kontraktual, ashtu si edhe mbikqyrjen e vendit dhe aktivitetet qe kane te bejne me menaxhimin e projektit; dhe
- *Veprimtaria e institucioneve*, (perfshi rrogat dhe shpenzimet e zyrave) si ato te diskutuara me siper, duke perfshire agjensite e planifikimit, zhvillimit ekonomik dhe te infrastruktures etj.
- *Kostot e Huave* (perfshi dhe grantet e administrimit) qe behen per financimin e (a) kontratave te ndertimit perpara dhenies se trualleve; (b) huave per blesesit e trualleve; (c) huave per zhvillimin ekonomik (per bizneset e reja etj).

Ne kete stad eshte e veshtire te parashikohet kjo ne detaje.

**Nje Zyre per Menaxhimin e Projektit;** nje plan rajonal kerkon nje njesi te vogel qendrore por te fuqishme qe te pergatise me detaje dhe te menaxhoje ne menyre te gjithanshme te gjithe procesin. Do te behej gabim nese do te lejohej qe procesi i implementimit te planit te perfundonte ne nje bashkesi projektesh te vegjel per kete apo ate, ku secili i lidhur te entitetet individuale (d.m.th., agjensi te klientit, te perfituesit, te financuesit dhe ekzekutive per 'projekte' te vecanta). Do te ishte ne interes te Shqiperise se Veriut te krijonte nje zyre te vetme kompetente te implementimit te planit rajonal. Ndoshta duhet te sigurohet nje financim i vecante per kete agjensi nga Komisioni Evropian.

Ne parashikuar nje proces vete-financues per sigurimin e tokave me sherbime te kryera per ndertime. Megjithate, ky proces 'vete-financues' ka nevojte per nje nxitje qe te filloje te levize. Sic u pershkrua ne Kapitullin 6, do te nevojiten plane lokale te detajuara dhe dokumente kontraktuale per infrastrukturen, plus financimi fillestar per ndertimin. Ne parashikojme shlyerjen brenda 5 vitesh, le te themi. Rrjedhimisht, kostot do te perfshijne dy elemente: (a) kapital per nje banke ndertimesh dhe nje banke me premisa biznesi duke perdorur truallet si kolaterale per huate afat-shkurtra; (b) grante per institucionet implementuese qe te perballojne mbulimin e rrogave te tyre, faturat dhe shpenzimet administrative; (c) hua per infrastrukturen qe te financohen kontratat, e cila do te shlyhet nga fluksi i pagesave nga familjet dhe bizneset.

## **11.5 MONITORIM I PROGRESIT PERMES TE DHENAVE TE TREGUESVE**

### **11.5.1 Hyrje**

Ne nje sens praktik, perpjekja per te percaktuar qellimet dhe objektivat do te ishte e pakuptimte, nese nuk do te mund te auditonim (dmth. te matnim) permbushjen e tyre. Kjo eshte detyra e 'Treguesve'. Duhet ngritur nje sistem i cili te lejoje mbledhjen e te dhenave ne intervale te njepasnjeshme, qe te kuptojme nese jemi drejt suksesit ose (deshtimit.)

Nje sistem i tille informacion-mbledhes, gjithmone funksionon me mire kur behet me nje pune rutine te vazhdueshme dhe perseritese. Ne duhet te identifikojme organizata te ndryshme qe te mbledhin dhe perfaqesojne keto te dhena, dhe te dorezohen ne nje agjensi qendrore, detyra e se ciles te jete raportimi i arrijtes se planit.

Ne propozojme tete fusha te nderlidhura informacioni, konkretisht ato rreth:

- (a) Te Drejtat e Prones se Patundshme
- (b) Popullsia
- (c) Toke per Zhvillim
- (d) Akses
- (e) Infrastruktura Fizike
- (f) Infrastruktura Sociale
- (g) Mjedisi
- (h) Zhvillimi Ekonomik

### **11.5.2 Tete Fusha Informacioni te Nderlidhura**

**(A) Te Dhena per Pronen e Patundshme**  
Pronesia, e dhene kjo me qera, e diskutuar dhe e panjohur

**(B) Te Dhena per Popullsine**  
Popullsia brenda rajonit urban (qytete, qyteza, fshatra) si dhe brenda zonave te thella te largeta (sidomos nyjat ekonomike rurale, fshatrat kyc, fshatrat mbeshtetes, dhe zonat ne renie.)

**(C) Te Dhena per Token per Zhvillim**  
(a) Zona toke te caktuara per rritje dhe 'shperndarje' (sipas 'planeve lokale').  
(b) Toka zhvillimi ilegal (ne zona jo-zhvillimi) dhe marrje e masave perforcuese.  
(c) Zhvillime legale te tjera per qellime te rigjenerimit urban dhe mbeshtetje bujqesore.

**(D) Te Dhena per Aksesin**  
(a) Percaktimi i rrugeve paresore dhe sekondare; kushtet e deshiruara/reale; realizimi i ndertimit/mirembajtjes.  
(b) Rruge te treta ose hyrese te percaktuara ne Zonat e Planifikuara per Rritje; realizim i ndertimit; akses ne numrin e parcelave.

**(E) Te Dhena per Infrastrukturen Fizike; (Uji, Kanalizimet/Kullimet, Energjia)**  
(a) Projekte paresore dhe dytesore te propozuara dhe te ekzekutuara  
(b) Sistemet tretesore ne Te Drejten Publike te Kalimit te planifikuara dhe te ndertuara. Lidhje me sheshet e ndertimit.  
(c) Paraqitje e Planit te Biznesit nga entitetet infrastrukturore (te ardhura/shpenzime)

**(F) Te Dhena per Infrastrukturen Sociale**  
(a) Shkollat: lehtesira ekzistuese, ujembledhes. Projekt-plane dhe dorezimi i tyre.

- (b) Lehtesira per Shendetesine: lehtesira ekzistuese, ujembledhes. Projekt plane dhe dorezimi i tyre.

**(G) Te Dhena per Mjedisin**

- (a) Projekte per rimekembjen mjedisore: progres drejt plotesimit.
- (b) Ndertim ilegal ose i pavend (apo zhvillime te tjera) brenda zonave te cenueshme. Marrje masash perforcimi.

**(H) Te Dhena per Zhvillimin Ekonomik**

- (a) Lokalizim i bizneseve sipas mases (te punesuar) dhe Klasifikimit Industrial Standard (SIC); shkalla e lindjeve (dhe vdekjeve); pagimi i taksave.
- (b) Burimi dhe lloji i financimit. Huate e kreditoreve dhe sektorit te biznesit.

**11.5.3 Sistemi i Auditimit (ose Monitorimit)**

Per çdo plan strategjik hapesor, duhet te percaktohet nje skuader per mbledhjen dhe perditimin e informacionit. Duhet te pergatise nje raport per çdo vit, nepermjet auditimit (dmth monitorimit) te suksesit te planit. Duhet te ekzistonte nje plan kombetar. Te kete (ne rekomandojme) nje Plan Hapesor Kombetar dhe kater Plane Hapesorore Rajonale, bashke me nje raport vjetor auditimi qe t'i mbuloje qe te pesta ne nje raport te vetem. Ky raport duhet gjithashtu te permbaje politiken e vleresimit, qe te perditesoje çdo vit te pese planet sipas nevojës.

Kush do te ishte pergjegjes per kete sistem? Sigurisht, politika e drejtimit duhet t'i perkase Ministrise pergjegjese per planifikimin hapesor, (ose sic quhet ne Shqiperi, 'Rregullim Territorial'). Drejtimi teknik i perket agjensise pergjegjese per menaxhimin e te dhenave, (konkretisht INSTAT,) nen drejtimin e liderit te posatshem.